



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN**

**STRUKTURA E PAGAVE**

Pagat e Gjyqtarëve dhe Kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan rregullohen me Ligj Nr.9877, datë 18.2.2008 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” (Ndryshuar me ligjin nr.114/2013, datë 11.4.2013), i përditësuar, përkatësisht Neni 26/1/3 përcakton:

*“Paga e gjyqtarit dhe e kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë (Ndryshuar me ligjin nr. 114/2013, datë 11.4.2013).*

*1. Paga për funksion e gjyqtarit në Gjykatën e Shkallës së Parë është e barabartë me 60 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Pas 5 vjet vjetërsie në shërbim, për çdo vit vjetërsi, kjo pagë, deri në 25 vjet shërbim, shtohet me 2 për qind në vit, por jo më shumë se paga e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.*

*3. Paga për funksion e Kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë është e barabartë me 60 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Mbi pagën për funksion jepet një shtesë për drejtim në masën 10 për qind. Pas 5 vjet vjetërsie në shërbim, për çdo vit vjetërsi, kjo pagë, deri në 25 vjet shërbim, shtohet me 2 për qind në vit, por jo më shumë se paga e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.”*

Struktura e pagave të administratës së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan është në përputhje me Vendim Nr. 187 datë 8.3. 2017 “Për Miratimin e Strukturës dhe e Niveleve të Pagave të Nëpunësve Civilë/Nëpunësve, Zëvendësministrit Dhe Nëpunësve të Kabineteve, në Kryeministri, Aparatet e Ministrive të Linjës, Administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, Disa Institucione të Pavarura, Institucionet në Varësit Kryeministrit, Institucionet në Varësi të Ministrave të Linjës dhe Administratën e Prefektit (1)(2).” sipas Struktura e Pagave Lidhja 7/1.

**Lidhja nr. 7/1**

**Klasat e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve civilë gjyqësorë në gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë, si dhe nëpunësve civilë të prokurorisë në prokuroritë pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm dhe gjykatat e shkallës së parë me juridik.**

<b>Pozicioni</b>	<b>Klasa e pagës</b>	<b>Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimit në pozicionin përkatës të punës (paga e grupit)</b>
Pjesa e I- Niveli i parë i gjykatave të apelit dhe gjykatave të shkallës së parë, si dhe i prokurorive pranë gjykatave të apelit dhe gjykatave të shkallës së parë sipas përcaktimit përkatësisht të KLGJ-së dhe të Prokurorit të Përgjithshëm		
Kancelar.	I-4	1
Drejtor i drejtorive të përmbajtjes. Ndihmës ligjor në gjykatat e apelit.	II-1	1
Drejtor i drejtorive mbështetëse.	II-2	1
Kryesekretar. Përgjegjës sektori.	III-1	1
Përgjegjës sektori.	III-2	1
Sekretar gjyqësor. Sekretar në sekretarinë e prokurorisë. Specialist.	IV-1	1 ose 2
Specialist.	IV-2	1 ose 2 ose 3
	IV-3	
Pjesa e II- Niveli i dytë i gjykatave të apelit dhe gjykatave të shkallës së parë, si dhe i prokurorive pranë gjykatave të apelit dhe gjykatave të shkallës së parë sipas përcaktimit përkatësisht të KLGJ-së dhe të Prokurorit të Përgjithshëm		
Kancelar. Ndihmës ligjor në gjykatat e apelit.	II-1	1
Drejtor drejtorie.	II-2	1
Kryesekretar. Përgjegjës sektori.	III-2	1
Sekretar gjyqësor. Sekretar në sekretarinë e prokurorisë.	IV-1	1 ose 2
Specialist.	IV-2	1 ose 2 ose 3
	IV-3	
Pjesa e III- Niveli i tretë i gjykatave të apelit dhe gjykatave të shkallës së parë, si dhe i prokurorive pranë gjykatave të apelit dhe gjykatave të shkallës së parë sipas përcaktimit përkatësisht të KLGJ-së dhe të Prokurorit të Përgjithshëm		
Ndihmës ligjor në gjykatat e apelit.	II-1	1
Kryesekretar. Përgjegjës sektori.	IV-1	1
Sekretar gjyqësor. Sekretar në sekretarinë e prokurorisë. Specialist.	IV-2	1 ose 2 ose 3
Specialist.	IV-3	1 ose 2 ose 3